



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

Oda e Mjekëve të Kosovës



Raport i Punës për tremujorin e tretë

Korrik-Shtator, 2024

Prishtinë, Tetor 2024

Ky raport paraqet punën e OMK-së për periudhën Korrik-Shtator të vitit 2024.

Raporti përmbledhë aktivitetet e të gjitha njësive organizative të OMK-së, duke u koncentruar në fushat kryesore, të cilat përbëjnë objektivat e punës së Odës.

Përmbajtja:

1. Këshilli Drejtues.....	4
2. Këshilli Mbikëqyrës.....	4
3. Anëtarësimi	5
4. Mbikëqyrja etiko-profesionale	6
5. Edukimi i Vazhdueshëm Profesional.....	7
6. Licencimet.....	7
7. Komisioni për Çështje Etike i OMK-së	7
8. Komisioni për Edukim Specialistik	8
9. Komisioni për Solidaritet dhe Ndihmë Reciproke	8
10. Raporti financiar	8
10.1 Raporti financiar për periudhën Korrik- Shtator 2024	8
10.2 Prokurimi.....	9
11. Aktivitete të tjera.....	9
11.1 Zgjedhjet e Parakohshme të OMK-së.....	9
11.2 Kongresi i VI i Mjeksisw Diagnostike.....	9
11.2 Tryeza e Rrubullakët	10
11.3 Platforma digjitale	10
11.4 Analiza gjithëpërfshirëse e djegies profesionale (burnout) të mjekëve në Kosovë.....	11
11.5 Revsita Mjeku – Mjekësia Diagnostike.....	12
11.6 Marrëdhëniet ndërkombëtare.....	12
12. Bashkëpunimi profesional dhe veprimtaria ekspertike	13
13 Plani i veprimit për 2024	13

1. Këshilli Drejtues

Këshilli Drejtues i OMK-së ka mbajtur 3 takime dhe një votim online ku janë shqyrtuar lëndët si më poshtë:


Organi	Numri i lëndëve të pranuar për periudhën korrik - shtator	Vendimet/Përgjigjet sipas kërkesave/ ankesave të pranuar për periudhën korrik - shtator	Vendimet në procedurë	Vendimet e Këshillit Drejtues për periudhën korrik - shtator	Vendime/Pergjigje për lëndët e bartura nga periudhat paraprake
Këshilli Drejtues i Odës	8	10	0	<ul style="list-style-type: none"> - Vendim për aprovim të Raportit të Punës për tremujorin e dytë të vitit 2024; - Vendim për themelim të Komisioni Ad-Hoc për dhënien e Dekoratave dhe Mirënjohjeve nga OMK; - Vendim për formim të grupit punues për draftimin e Rregullorës për Përkrahje Financiare për Botim të Librit; - Vendim për përkrahje financiarë të botimit të librit Kirurgët Abdominalë në QKUK (1969-2022); 	0

2. Këshilli Mbikëqyrës


Këshilli Mbikëqyrës i OMK-së ka mbajtur 5 takime ku i kanë shqyrtuar Projektligjin për Shëndetësi, Udhërrëfyes Klinik, Raportin e tremujorit të dytë të punës së OMK-së, Vendimet e Këshillit Drejtues, dhe të organeve të tjera të OMK-së.

3. Anëtarësimi

Në Odën e Mjekëve të Kosovës u anëtarësuan 82 mjekë, nga të cilët 6 mjekë të punësuar në sektorin publik, 8 mjekë të punësuar në sektorin privat, 68 mjekë të papunë.



Grafiku 1.1: Anëtarësimet për periudhën kohore Korrik - Shtator 2024



Grafiku 1.2: Totali i përgjithshëm i anëtarëve deri më datën 30 Shtator 2024

Gjatë kësaj periudhe janë ndarë nga jeta 7 mjekë, si dhe janë rianëtarësuar 4 mjekë, si rezultat numri total i anëtarëve deri me datën 30 shtator është 5341 mjekë.

4. Mbikëqyrja etiko-profesionale

Për ta pasqyruar ecurinë e mbikëqyrjes etike dhe profesionale pranë Prokurorit të OMK-së, në mënyrë tabelare do të paraqesim ushtrimin e funksionit të tillë nga ana e Prokurorit të OMK-së.

Gjatë këtij 3 mujori më certifikata për të kaluarën etike dhe profesionale janë paisur gjithsej: 237 Mjek, prej të cilëve 27 mjek kanë marrë certifikata të kaluarës etike dhe profesionale për përdorim jasht vendit.

Ndërsa 210 mjek, që kanë marrë certifikata të kaluarës etike dhe profesionale për shtesat e nëpunësve shëndetësor, për konkurse brenda vendit dhe mjek që kanë marrë certifikata të kaluarës etike dhe profesionale ndër vite.


Sipas pyetësorit për arsyet e largimit të mjekëve nga Kosova, 85% e mjekëve kanë deklaruar se arsye kryesore kanë qenë:

1. Kushtet jo të mira të punës;
2. Mungesë e punësimit, dhe
3. Paga të ulta

ORGANI	Numri i lëndëve të pranuar për periudhën TM3	Vendimet sipas procedurës së zhvilluar për periudhën TM3	Sanksionet e shqiptuara për periudhën TM3	Sanksionet e ekzekutuara për periudhën TM3	Lëndët e bartura nga periudhat paraprake	Lëndët në shqyrtim
Prokurori i Odës	19	8	N/A	N/A	32	43
Këshilli Etik	6	10	1. Gjobë. 2. Rekomandime kolegjale 1. Qortim publik	//	10	6
Gjyqi i Nderit	2	0	//	//	//	2
Certifikatat e të kaluarës etike total	237	//	//	//	//	//


5. Edukimi i Vazhdueshëm Profesional

Komisioni për Edukimin e Vazhdueshëm Profesional, ka akredituar gjithësejt 10 aktivitete. Në kuadër të aktiviteteve të akredituara, prej këtyre akreditimeve 5 janë me taksë administrative.



6. Licencimet

Komisioni për Licencim dhe Rilicencim profesional, ka lëshuar gjithësejt 316 licenca me kategoritë si në grafikun e mëposhtëm:



7. Komisioni për Çështje Etike i OMK-së

Komisioni për Çështje Etike i OMK-së ka pranuar gjithsejt 27 kërkesa për të cilat ka nxjerrë 19 vendime aprovuese, (nga të cilat 12 vendime për leje-hulumtim, 6 për

kthime të raporteve, 1 vendim për kohezgjatje) ndërsa 1 vendim refuzues për lejehulumtim dhe 7 lëndë janë kthyer për plotësim.

8. Komisioni për Edukim Specialistik

Komisioni për Edukim Specialistik ka mbajtur 2 takime, ku është diskutuar rreth rregullores.

9. Komisioni për Solidaritet dhe Ndihmë Reciproke

Komisioni për Solidaritet dhe Ndihmë Reciproke i OMK-së ka pranuar gjithsej 7 kërkesa për përkrahje financiare. Komisioni ka nxjerrë 5 vendime për aprovimin e kërkesave të parashtruara nga palët dhe 1 vendim për refuzim të kërkesë, ndërsa 1 kërkesë është kthyer për plotësim lënde.

10. Raporti financiar

10.1 Raporti financiar për periudhën Korrik- Shtator 2024

RAPORTI FINANCIAR PËR PERIUDHËN JANAR - SHTATOR 2024				
1.0 Të hyrat:				
1.1 Paraja në bankë me 31.12.2023	€	825,695		
Total Paraja në bankë me 31.12.2023				€ 825,695
1.2 Të hyrat	Realizimi: TM1	Realizimi: TM2	Realizimi: TM3	TOTAL
1.2.1 Të hyrat nga anëtarësia:				
1.2.2 Anëtarësimi i mjekëve shtetas kosovarë	€ 355,325	€ 129,870	€ 21,900	€ 507,095
1.2.3 Anëtarësimi i mjekëve shtetas jo kosovarë	€ 3,450	€ 2,100	€ 1,530	€ 7,080
1.2.2 Licencimi	€ 14,215	€ 11,750	€ 12,790	€ 38,755
1.2.3 Të hyrat e tjera*	€ 9,858	€ 8,571	€ 18,305	€ 36,733
Të hyrat deri me 30.09.2024	€ 382,848	€ 152,291	€ 54,525	€ 589,664
Paraja në bankë me 31.12.2023				€ 825,695
TOTAL TË HYRAT				€ 1,415,359
2.0 SHPENZIMET				
	Shpenzimet: TM1	Shpenzimet: TM2	Shpenzimet: TM3	TOTAL
2.1 Paga, medijtje dhe kontributet pensionale	€ 72,121	€ 69,594	€ 72,419	€ 214,134
2.2 Material shpenzues	€ 814	€ 661	€ 1,312	€ 2,787
2.3 Reprerentacioni	€ 1,051	€ 698	€ 733	€ 2,482
2.4 Edukimi i vazhdueshëm profesional	€ 33,660	€ 59,633	€ 22,582	€ 115,876
2.5 Shpenzimet e tjera*	€ 8,620	€ 20,521	€ 25,548	€ 54,689
2.6 Shpenzimet e aseteve	€ 634	€ 219	€ 106	€ 958
2.7 Përkrahje financiare në kuadër të fondit për solidaritet	€ 1,750	€ 18,200	€ 4,500	€ 24,450
TOTAL SHPENZIMET 30.09.2024	€ 118,650	€ 169,526	€ 127,201	€ 415,377
Neto të hyrat për TM	€ 264,197	€ (17,235)	€ (72,675)	€ 174,286
TOTAL BILANCI 30.09.2024				€ 999,981

Faksimili, Faksimili i dytë, Certifikata për të kaluarën etike profesionale, Taksa për paraqitjen e provimit, Kongreset, simpoziumet, seminarët, Lejimi për hulumtime për persona juridik, Të ardhurat nga interesi BKT, Dhurata / donacione, Të ardhurat të tjera.

2.5*Faksimili, Shpenzimet për botimin e revistës, Organizimi i mbledhjeve të kuvendit, Shpenzimet e ID kartelave të Odë, Shpenzime të përkthimeve/lektorimit, Meditje për udhëtime zyrtare, Trajnime për stafin, Mirembajtja e softverit për financa, Shpenzimet e tel., Shpenzimet e int., Shpenzimet e postës, Pajisje të IT, Shpenzime bankare, Shpenzimet e pastrimit, Shpenzimet e transportit, Shpenzimet e tjera operative.

10.2 Prokurimi

Në muajin korrik, u zhvillua 1 procedurë e hapur e prokurimit për shërbimet e hapsirës për mbajtjen e Simpoziumit ZEVA. Procedura e prokurimit u zhvillua me sukses dhe brenda afatit u lidh kontrata me operatorin ekonomik.

Po ashtu gjasht muajin korrik, u përzgjedh operatori ekonomik për një analizë gjithëpërfshirëse të djegies profesionale (burnout) të mjekëve në Kosovë.

Ne muajin gusht, me procedurë për vlera të vogla të prokurimit, është bërë përzgjedhja e operatorit të suksesshëm ekonomik, dhe brenda afatit u lidh kontratë për shërbime për video dhe fotografi për OMK-në.

11. Aktivitete të tjera

11.1 Zgjedhjet e Parakohshme të OMK-së

Oda e Mjekëve të Kosovës shpalluar zgjedhje të parakohshme në tre njësi zgjedhore: QKMF Malishevë, Spitali i Përgjithshëm Ferizaj, dhe Spitali Amerikan. Qëllimi i zgjedhjeve ishte plotësimi i vendeve ku njesit zgjedhore kanë mbetur pa përfaqësues për shkak se përfaqësuesit e mëparshëm kanë ndrruar vendin e punës apo janë pensionuar. Prandaj sipas Kodit zgjedhor të KQZ-së së OMK-së duhet të mbahen zgjedhjet për plotësimin e vendeve për përfaqësues në Kuvendin e OMK-së, legjislatura e III-të.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) shqyrtoi të gjitha aplikacionet dhe certifikoi kandidatët që plotësuan kriteret. Pas certifikimit të kandidatëve zgjedhjet u mbajtën në dy njësi zgjedhore, në QKMF Malishevë dhe Spitalin Amerikan.

Rezultatet përfundimtare u publikuan nga KQZ për QKMF Malishevë dhe Spitalin Amerikan, duke përmbyllur suksesshëm procesin e zgjedhor të parakohshme të OMK-së.

11.2 Kongresi i VI i Mjekësisë Sfidat e Diagnostikës së Mijëvjeçarit

Kongresi i VI i Mjekësisë Diagnostike ndër aktivitetet kryesore që Oda e Mjekëve ka planifikuar të realizoj për vitin 2024 është Kongresi Mjekësor. Kongresi është paraparë që të jetë i fokusuar në lëminë e Diagnostikës specifikisht specilizimet (Patologji, Radiologji, Biokimi Mjekësore, Mjekësi Nukleare dhe Mikrobiologji.

Organizimi i Kongresit të VI i Mjekësisë ka filluar në muajin Prill 2024, ku OMK kishte formuar Këshillin Organizativ dhe Shkencor të përbërë gjithësej nga 18 anëtarë. Këshilli organizativ gjatë muajit maj ka mbajtur dy takime ku vendosi që një pjesë e anëtarëve të këshillit organizativ të formojnë këshillin shkencor.

Këshilli Shkencor ka mbajtur pesë takime, ku sipas përgjegjësive ka bërë caktimin e kriterëve për dorëzimin e punimeve shkencore, caktimin e mënyrës dhe kohën e prezantimeve, vlerësimin e abstrakteve të pranuar me përputhshmërinë e tematikës së kongresit dhe propozimi i emrave për ligjerues të ftuar.

Këshilli Organizativ ka mbajtur katë takime për organizimin dhe mbarvajtjen e punimeve të kongresit.

Nder vendimet e para të marra nga Këshilli Organizativ ishin që Kongresi të mbahet me datë 18 dhe 19 tetor 2024, ndarë në 8 sesione.

Mënyra e mbajtjes së Kongresit është paraprë që të jetë fizikisht dhe numri i paraprë sipas kapaciteteve organizative është 2000 pjesëmarrës këtu përfshirë edhe pjesën e ligjëruesve.

11.3 Tryeza e Rrubullakët

Tryeza e Rrubullakët është organizuar në bashkëpunim me të Odat e Profesionstëve Shëndetësorë, temë kyçe ka qenë Projektligji i Shëndetësisë i projektuar në muajin Gusht.

11.4 Platforma digjitale

Oda e Mjekëve të Kosovës (OMK) ka realizuar një projekt të rëndësishëm për të digjitalizuar shërbimet e saj për anëtarët, duke krijuar një platformë të avancuar elektronike, online.omk-rks.org. Kjo platformë u lansua në shtator dhe është mbështetur nga Qeveria e Dukatës së Madhe të Luksemburgut përmes projektit KSV/017.

Platformë shërben si një sistem i centralizuar për menaxhimin e anëtarësisë së mjekëve, që lejon përpunimin e të dhënave të tyre me synim përmirësimin e cilësisë së shërbimeve dhe vendimmarrjen strategjike në sektorin e shëndetësisë. Objektivat kryesore janë:

- Mbështetja e të gjitha shërbimeve të OMK-së përmes një sistemi të unifikuar dhe të qëndrueshëm.
- Përmirësimi i komunikimit të brendshëm dhe cilësisë së të dhënave.
- Lehtësimi i qasjes së anëtarëve për përfitimin e shërbimeve.
- Rritja e eficiencës dhe reduktimi i burokracisë për OMK-në.

Funksionalitetet Kryesore të Platformës:

1. **Anëtarësimi dhe licencimi:** Mjekët mund të aplikojnë për anëtarësim dhe licencim të ri ose rilicencim përmes platformës, duke dërguar dokumentacionin e nevojshëm në mënyrë digjitale.
2. **Pagesat e anëtarësisë:** Anëtarët mund të bëjnë pagesa online, duke lehtësuar menaxhimin e financave për OMK-në.
3. **Edukimi i vazhdueshëm profesional:** Platforma mundëson monitorimin e trajnimeve profesionale të mjekëve, duke siguruar përditësimin e vazhdueshëm të aktiviteteve të tyre.
4. **Shërbime administrative:** Anëtarët mund të kërkojnë vërtetime të ndryshme dhe dokumente të tjera për qëllime profesionale.

Platforma digjitale e OMK-së synon të përmirësojë shërbimet dhe të thjeshtëzojë ndërveprimet mes anëtarëve dhe OMK-së. Për OMK-në, platforma ofron mundësinë e përpunimit dhe analizimit të të dhënave, duke e bërë menaxhimin e anëtarësisë më të lehtë dhe më efikas, me potencial të rëndësishëm për të mbështetur planifikimin strategjik dhe zhvillimin e ardhshëm të shërbimeve.

11.5 Analiza gjithëpërfshirëse e djegies profesionale (burnout) të mjekëve në Kosovë

Ky hulumtim analizoi faktorët që ndikojnë në djegjen profesionale (burnout) të mjekëve në Kosovë, me fokus në nivelin e stresit psikologjik dhe djegjen profesionale e lidhur me punën. Ky studim u zhvillua me qëllimin për të kuptuar më mirë sfidat me të cilat përballen mjekët dhe faktorët që nxisin migrimin e tyre, duke ndihmuar në përmirësimin e politikave dhe strategjive për burimet njerëzore në sektorin shëndetësor.

Në këtë hulumtim janë përdorur një kombinim të metodave kuantitative dhe kualitative, përfshirë një sondazh online për të matur stresin dhe djegjen profesionale e mjekëve, si dhe grupe fokusesh dhe intervista të thelluara me mjekë brenda dhe jashtë vendit. Sondazhi përfshinë 529 mjekë anëtar të OMK-së, ndërsa diskutimet u realizuan me mjekë të spitaleve publike dhe private dhe me ata që kanë emigruar në vendet e zhvilluara.

Rezultatet Kryesore:

- **Djegja profesionale:** 47.4% e mjekëve treguan nivele të larta të hargjimit emocional dhe depersonalizimit në punë, duke përjetuar lodhje të madhe profesionale.
- **Faktorët kryesorë të stresit:** Ngarkesa e madhe në punë, mungesa e burimeve të nevojshme, mundësitë e kufizuara për zhvillim profesional, dhe mungesa e

mbështetjes menaxheriale u identifikuan si faktorë kryesorë që kontribuojnë në stresin dhe djegjen profesionale.

- **Migrimi i mjekëve:** Mungesa e kushteve të mira të punës dhe pagave të ulëta janë faktorët kryesorë që nxisin migrimin. Shumica e mjekëve të anketuar treguan se kanë në konsideratë emigrimin për kushte më të mira profesionale dhe sociale jashtë vendit.

11.6 Revista Mjeku – Mjekësia Diagnostike

Vëllimi 4, Numri 3 i Revista Mjeku ka temën bosht Mjekësia Diagnostike, i cili u publikua gjatë muajit Shator 2024. Ky numër përbëhet gjithsej nga 20 artikuj të përmbledhura në 82 faqe, ku trajtohen tema interesante dhe me rëndësi për lëminë e mjekësisë diagnostike. Revista është publikuar në web-faqen e OMK-së, faqe zyrtare të facebookut si dhe është printuar në një numër të caktuar kopjesh. Të bashkangjitur mëposhtë linkun e publikimit të këtij numri:

[RevistaMjeku](#)

11.7 Marrëdhëniet ndërkombëtare

Simpoziumi i 31-të të Odave të Mjekëve të Evropës Qendrore dhe Lindore (ZEVA). Oda e Mjekëve të Kosovës organizoi simpoziumi i 31-të të ZEVA-s në Prishtinë, një ngjarje tre-ditore ku u mirëpritën përfaqësues nga 10 vende anëtare dhe një delegacioni nga Ukraina. Simpoziumi ofroi një platformë për diskutime mbi çështjet aktuale dhe sfidat e sektorit shëndetësor evropian. Kryetari i OMK-së, Dr. Pleurat Sejdiu, mbajti një prezantim mbi rolin e Odës së Mjekëve në sistemin shëndetësor dhe në trajnimin specialistik. Sesionet e diskutimeve trajtuan temat:

1. **Trajnimi specialistik**, ku vendet pjesëmarrëse prezantuan raportet e tyre mbi rolin e odave në këtë aspekt.
2. **Kushtet e daljes në pension dhe rilicencimi i mjekëve të moshuar**, ku delegacionet ndanë përvojat e tyre mbi standardet e pensionimit dhe procedurat e rilicencimit.

Kryetari i Komitetit të Përhershëm i Mjekëve të Europë (CPME), Dr. Christiaan Keijzer, prezantoi përditësimet dhe të njoftimet e reja mbi politikat shëndetësore të BE-së,

Në sesionin e dedikuar për delegacionin e Ukrainës, diskutimet u fokusuan në ligjin e ri të Ukrainës për vetëqeverisjen mjekësore dhe u prezantua eksperiencia e vendit në integrimin e mjekësisë civile dhe ushtarake. Ndërsa Dr. Sejdiu shtjelloi problematikën e

"ikjes së trurit" të mjekëve dhe prezantoi sfidat e sektorit shëndetësor të Kosovës pas luftës.

12. Bashkëpunimi profesional dhe veprimtaria ekspertike

Në kuadër të kompetencës publike lidhur me mbikëqyrjen e veprimtarisë profesionale të mjekëve, Kryetari i OMK-së duke u bazuar në kompetencat ligjore sipas Ligjit për OPSH-të, në bazë të kërkesave nga Këshilli Etik i OMK-së, Prokurori i OMK-së, Gjykatat Themelore ka caktuar ekspert apo grupe të ekspertëve lidhur me konstatimin e përgjegjesisë profesionale mbi zbatimin e procedurave mjekësore nga mjekët gjegjës.

Organi	Numri i lëndëve të pranuar për periudhën korrik - shtator	Vendimet sipas urdhëresave/kërkesave të pranuar për periudhën korrik - shtator	Në procedurë	Raportet e ekspertizave të përfunduara për periudhën korrik - shtator	Vendime për lëndët e bartura nga periudhat paraprake
Kryetari i Odës	6	3	1	0	0

*Në këtë periudh kohore 3 lëndët e pranuar nga Gjykatat dhe Prokuroritë janë kthyer prapa me arsyetimin sepse nuk është duke u ekzekutuar asnjë pagesa e ekspertëve të caktuar nga Oda e Mjekëve, ndërsa 3 lëndë/kërkesa janë nga Prokurori i Odës dhe Komioni për Çështje Etike.

13 Plani i veprimit për 2024

Projektet/Planet 2024

- Vazhdimi i realizimit të Projektit për ndërtimin e objektit për të gjitha OPSH-të, financuar nga Projekti KSV/017 “Përkrahja për sektorin e shëndetësisë” dhe OPSH-të. Në këtë fazë sipas procedurave administrative dhe hapave të planifikuar deri në përfundim të projektit, kemi pranuar lejën për kushtet ndërtimore nga komuna e Prishtinës. Hapi i ardhshëm i projektit është që të bëhet plani detal i objektit nga arkitektët, si rezultat OPSH-të së bashku me projektin Luxembourg Development të bëjnë hapjen e tenderit për fillimin e punimeve.
- Vazhdimi i zbatimit të projekteve për profilizim dhe shkollim specialistik jashtë vendit, bazuar në marrëveshjen mes OMK dhe SHSKUK.

- Vazhdimi i zbatimit të Marrëveshjes për Delegimin e Fondeve dhe Implementim projekti KSV/017-21 2749. Deri në fund të vitit janë të planifikuara të realizohen dy vizita studimore dhe tre trajnime.